
**MBISHKRIMI ME TOPONIMIN ALBANOPOLIS I GJETUR NË SHKUP
THE INSCRIPTION ALBANOPOLIS OF SKOPJE**

MIXHAIT POLLOZHANI

Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë, MACEDONIA

Email: mixhat_p@yahoo.com

AKTET VI, 4: 447-451, 2013**PERMBLEDHJE**

Qëllimi i ri-interpretimit të një mbishkrimi me tekst latin, por me përmbajtje mbi të kaluarën e këtyre anëve na çoi deri te rikonfirmimi i të dhënave onomastike ilire. Edhe pas më shumë se 80 vjetëve që nga zbulimi i mbishkrimit, ai mbetet i pari por edhe i vetmi i këtij lloji i zbuluar deri më tani në territoret ilire. Mbishkrimi në fjalë flet për ekzistimin e një vendbanimi të antikitetit, nën rrënojat e të cilit ruhet thesari arkeologjik që ravijëzon një dëshmi të rëndësishme mbi procesin historik të krijimit të popullit shqiptar. Fjala është për stelën (gurë varri) me një mbishkrim të rrallë në tekstin e të cilit përmendet emërtimi ALBANOPOLIS. Mbishkrimi i zbuluar në rrethinën e Shkupit është edhe një rikonfirmim arkeologjik i përshkrimeve gjeografike të Ptolomeut dhe hulumtimeve të studiuesit gjerman, Hahn, por edhe të hulumtimeve të deritanishme rreth qytetit të antikitetit ALBANOPOLIS që është i identifikuar në jug-perëndim të Krujës, në lokalitetin e quajtur Zgërdhesh.

Fjale kyçe: Mbishkrimi Albanopolisi nga Shkupi konfirmon Ptolomeun

SUMMARY

The goal of the reinterpretation of an inscription with an Latin text but with a content over the past of these sides lead us to the reconfirmation of the Illyrian onomastic data. Even 80 years after the discovery of the inscription, it remains the first and only of this type discovered until now in the Illyrian territory. The inscription is about the existence of an antique locality, under the ruins of which is preserved the archeological treasure which outlines an important evidence for the historical process of the creation of the Albanian nation. It's about the grave stone with a rare inscription in which text is mentioned the designation ALBANOPOLIS. The inscription discovered in Skopje area it is an archeological reconfirmation of the geographic descriptions of Ptolemy and of the researches of the Austrian explorer, Hahn, but also of the so far researches about the antique town of ALBANOPOLIS which was identified in south-west of Kruja, in the locality known as Zgerdesh.

Key words: The inscription Albanopolis of Skopje confirms Ptolemy

1. Hyrje

Ndër dëshmitë mjaft bindëse mbi të kaluarën historike të një populli apo të një vendi janë dokumentet e shkruara. Ndaj kur bëhet fjalë për epokat e antikitetit, atëherë materialet e epigrafisë përbëjnë burime primare të shkruara që vijnë nga terreni. Nuk janë pak në numër materialet e ndryshme epigrafike të botuara dhe të pabotuara me interes për studiuesit në (ri)interpretimin e përmbajtjeve të tyre. Pikërisht

ky është edhe qëllimi për t'iu rikthyer mbishkrimit me tekst latin, por me përmbajtje dhe domethënie të rëndësishme për të kaluarën ilire të këtyre anëve, i cili edhe pas më shumë se 80 vjetëve është i vetmi material epigrafik në të cilin përmendet emërtimi ALBANOPOLIS.

2. Historiku i zbulimit të mbishkrimit dhe publikimi i tij

Mbishkrimi në fjalë i zbuluar në fshatin, Gorno Sonje, i cili ndodhet në jug – perëndim të qytetit të Shkupit (në anën e pasme të lagjes dhe parkut Vodno dhe fshatit Nerez), ka dhënë dëshmitë e para dhe të vetme deri më tani me karakter epigrafik mbi ekzistimin e toponimit ALBANOPOLIS.

Për herë të parë këtë mbishkrim, në vitin 1930 e ka publikuar nëpërmjet një fotografie arkeologu serb, Nikolla Vuliç (Vulic 1931: 557). Ai mbishkrimin e gjeti të muruar (vendosur) në një çezmë të vjetër e të braktisur në perëndim të fshatit Gorno Sonje, ku gjendet edhe sot e kësaj dite. Duhet theksuar se dy rreshtat e fundit të mbishkrimit janë identifikuar shumë më vonë, gjatë rileximit të stelës në vitin 1968. Ndërkohë që, publikimi i tij i plotë është bërë në vitin 1981 nga studiuesja, Borka Dragojeviq – Josifovska (Dragojevic-Josifovska 1982).

Deri më tani këtë mbishkrim e kanë interpretuar studiues dhe arkeologë të huaj, por edhe shqiptarë. Studiuesja e njohur Fanula Papazogllu, ka sjellë disa konstatime të rëndësishme mbi këtë dokument me përmbajtje domethënëse onomastike. Ndërkohë që nga ana e studiuesit shqiptar Zef Mirdita (Mirdita 1981: 11-35), i cili ndonëse i ka paraqitur të plota të dhënat të këtij mbishkrimi, megjithatë toponimi ALBANOPOLIS kalon pa ndonjë trajtim të veçantë. As arkeologia Exhlale Dobruna-Saliu, në publikimet e hulumtimeve të saj këtij epitafi nuk i ka kushtuar ndonjë vëmendje të veçantë. Mbështetur në publikimet e deritanishme, por edhe nga informacionet e tjera që kemi në dispozicion kushtuar problematikës onomastike rezultoi se mbi këtë mbishkrimi kaq të rëndësishëm nuk dihet as edhe në Shqipëri.

3. Rikonfirmim arkeologjik i Ptolomeut dhe Han

Para se të sjellim vlerësimet mbi leximin dhe interpretimin e mbishkrimit në fjalë, së pari do të pasqyrojmë shkurtimisht burimet dhe hulumtimet e deritanishme që flasin mbi toponimin ALBANOPOLIS, emër të cilin e ka mbajtur një qendër e rëndësishme urbane e

antikitetit ilir. Qytetit antik i njohur me emrin ALBANOPOLIS është identifikuar në jug-perëndim të Krujës, në lokalitetin e quajtur Zgërdhesh (Islami, 1975: 217-238) i vendosur mbi një kodër me një pozitë dominuese mbi tërë hapësirën rreth e qark saj.

Rrënojat e ALBANOPOLISIT, zënë një sipërfaqe prej 10 ha, i cili ka qenë i fortifikuar me mure të fuqishme nga të cilët sot ruhen rreth 90 metra gjatësi dhe tri kulla. Ky është një toponim, i cili për herë të parë (dhe në të vetmin dokument të shkruar antik) përmendet në shekullin II nga autori antik Ptolomeu, te vepra e tij e njohur *Geographia* (*Gjeografia*). Kjo vepër e përbërë nga tabela dhe harta, sjell shënime dhe përcakton pozitat e vendbanimeve të botës antike sipas gradave të gjatësisë dhe gjerësisë gjeografike. Aty janë të evidentuara edhe shumë qytete dhe vendbanime të Ilirisë, Maqedonisë dhe të Epirit (Ptolemeu III, 12, 20). Përveç tjerash në atë vepër krahas toponimeve të tjera, gjithashtu për herë të parë haset edhe emri i fisit ilir - ALBANOI.

Të dhënat e Ptolomeut kanë zgjuar vazhdimisht interesin e studiuesve të ndryshëm për kërkimin në terren të rrënojave të qytetit antik në fjalë. Studiuesi gjerman Johan Georg fon Han, në vitin 1854 pasi kishte vizituar lokalitetin arkeologjik në një vendbanim në afërsi të qytetit të Krujës, është i pari që e hedh mendimin se qyteti antik ALBANOPOLIS duhet kërkuar nën rrënojat e Zgërdheshit (Hahn 1867: 14). Hipoteza e Hanit bazohet tek të dhënat e veprës *Geographia* (*Gjeografia*) të Ptolemeut, të shekullit II, duke e vendosur ALBANOPOLISIN antik në zonën midis Matit dhe Shkumbinit. Vetë përshkrimi i pozicionit gjeografik që jepet në të e lehtëson orientimin se ku përafërsisht duhej lokalizuar vendbanimi i vjetër. Hipoteza e Hanit mbetet me shumë vlerë, sepse në zonën e përmendur më sipër akoma nuk dihet për një qendër tjetër më të madhe antike se sa Zgërdheshi.

Gjatë Luftës së Parë Botërore, Zgërdheshin e ka vizituar edhe K. Prashniker, i cili ka lënë një përshkrim të shkurtër dhe një plan-skicë mbi lokalitetin në fjalë. Ndërkohë edhe krahasimi i të dy autorëve të përmendur nga arkeologu italian P. Sestieri nuk sollën ndonjë gjë të re.

Shikuar nga kjo distancë kohore mund të konstatohet, se, nëse Hani i verifikoi shënimet e Ptolomeut në terren, arkeologët shqiptarë nëpërmjet dy ekspeditave arkeologjike të realizuar në qytetin antik të Zgërdheshit (njëra në vitin 1969 dhe tjetra më 1973), të drejtuar nga arkeologu Selim Islami, kanë konfirmuar hipotezën e studiuesit gjerman J. G. V. Han (Islami 1975: 23).

Ndërkohë që mbishkrimi i zbuluar në rrethinën e Shkupit është edhe një rikonfirmim arkeologjik dhe epigrafik i përshkrimeve gjeografike të Ptolomeut, hulumtimeve të studiuesit gjerman Han, si dhe të hulumtimeve të tjera të deritanishme rreth qytetit ALBANOPOLIS.



Stela në çezmën e braktisur në fshatin Gorno Sonje të Shkupit

4. Karakteristika estetike

Stela nga Gorno Sonje e gdhendur në pllakë të mermerit të bardhë përbëhet nga dy pjesë kryesore: fushës relievoe dhe fushës së mbishkrimit. Në aspektin figurativ ajo përbën një realizim skulptural, ndërkaq në aspektin funksional paraqet një monument të rëndësishëm me karakter sepulkral nga epoka romake. Kjo stelë, si tërësi sepulkrale, shquhet edhe për karakteristikat e saj estetike, që i përket tipit *fronton harkor*, që është tipike vetëm për rrethinën e Shkupit (Dobruna-Salihu 2005:). Parë në tërësi, stela në fjalë në pjesën e poshtme dhe anash ruan formën e katërkëndëshit kënddrejtë, kurse nga brenda përbën një tërësi skulpturale të

kornizuar me anë të tri profileve dhe është e dekoruar me elemente gjeometrike, florale dhe kaligrafike.

Monumenti është i dëmtuar pjesërisht në pjesën e sipërme të tij, ndërkohë që atij i mungon plotësisht pjesa e poshtme. Stela sot ruhet në këto dimensione: gjatësia: 80.0 cm, gjerësia: 65.0 cm dhe thellësia: 24.0 cm.

Frontoni, i cili njëherësh përbën edhe pjesën e sipërme të stelës, ka formën e edikulës gjysmëharkore që është zbukuruar me dy akroterë të realizuar në relief të ulët me motivin e stilizuar të palmës, skajet e së cilës përfundojnë në formë valutash spiraloide. Fusha e brendshme e frontonit e njohur si edikula është zbukuruar me një rozetë të theksuar që përbën një stilizim floralo-gjeometrik.

5. Të dhëna onomastike ilire

Pjesa e poshtme që dominon stelën, i përket fushës së mbishkrimit (titulus), që po ashtu është e profilizuar, por, për shkak të dëmtimit të saj, mbishkrimi në fjalë nuk është i plotë. Supozohet se atij mbase i mungojnë edhe dy rreshta të tjerë të tekstit (ndoshta edhe më shumë?!). Sigurisht përmbajtja e kompletuar e epitafit do të sillte edhe të dhëna të tjera për vetë epitafin, por edhe për rëndësinë e karakterit të tij dokumentar dhe historik.

Teksti origjinal i mbishkrimit:

POSI MESTYLV F FL DELVS MVCATI F DOM
ALBANOP IPSA DELVS

/.../

Mbishkrimi i transkriptuar:

POSI MESTYLU F(ILIVS) FL(AVIA) DELVS MUCATI
F(ILIA) DOM(O)
ALBANOP(OLI) IPSA DELVS

/.../

Versioni i mbishkrimit të përkthyer në gjuhën shqipe:

Posis Mestylu, i biri i Flavia Delusë të bijës së tij Mucatus, me vendbanim në Albanopolis /--/

Edhe pse disa studiues e theksojnë dominimin e antroponimeve dhe patronimeve me origjinë dhe përmbajtje greke apo trakase, megjithatë përmbajtja e mbishkrimit në fjalë flet për të dhëna onomastike që lidhen me qenien ilire.

Përveç kontekstit të përdorimit të emërimit të vendbanimit ALBANOPOLIS, në këtë mbishkrim lexohen edhe disa emra për të cilët supozohet se janë me prejardhje ilire.

Sipas interpretimit të studiueses Borka Dragojeviq - Josifovska, e cila u referohet publikimeve të studiuesve të ndryshëm, del se dedikuese e këtij monumenti është Delus, e bija e Mucatis. Autorja në fjalë nuk përcakton saktësisht marrëdhëniet e Delusë me Posis, por supozon se kanë qenë një çift bashkëshortor. Gjithnjë sipas saj, Posis sa mund të jetë emër grek, po aq mund të jetë edhe emër trakas, por edhe ilir (Dragojevic-Josifovska 1971: 513-522).

Për Posis mendohet se mund të ketë qenë një pelegrin nga Scupi, sepse, në qoftë se ai kishte qenë me prejardhje nga qyteti Albanopolis, atëherë adresa e vendbanimit të tij natyrshëm do të ndiqte emrin e tij dhe jo të gruas së tij (Dragojevic-Josifovska 1982: 135-136). Pra nëse Posis ka qenë nga Skupi, atëherë mundësitë më të mëdha janë që ky të jetë antroponim ilir. Ashtu si babai i saj, Mestylu (ose Mestylus) edhe Delus që më parë është konsideruar si emër mashkullor, por, në këtë rast ai shfaqet si emër i një gruaje është një epihore, dhe ndoshta edhe ajo është një shtetase (vendase) ose një emigrante nga Maqedonia Veriore apo Iliria. Por meqenëse Delus shfaqet edhe në një mbishkrim të gjetur në lagjen Singjeliq (Dragojevic-Josifovska 1982: 109) në lindje të Skupit. Mucatis është një nga emrat që iliologët e marrin me saktësi si emër ilir (Mirdita, 1981: 35-78). Ai shfaqet edhe te një mbishkrim i fshatit Konjare e Mesme të Shkupit (Dragojevic-Josifovska 1982: 133).


Sigurisht që vëmendjen e tërheq emërtimi ALBANOPOLIS i cili përveç që përmban informacione të karakterit topografik, ai sjell informacione edhe për statusin administrativ të këtij qyteti antik. Duke u bazuar në të dhënat e Plinit mësohet se qyteti ALBANOPOLIS nuk ka ekzistuar gjatë sundimit të Augustit, por ai paraqitet në periudhën e Flavëve gjë që e dëshmon edhe mbishkrimi në fjalë.

Në mungesë të dy rreshtave të fundit të mbishkrimit nga Gorno Sonje, gjë që nuk

përrjashtohet mundësia që të ketë qenë akoma më i gjatë, me përvojën e mbishkrimeve të ngjashme të zbuluara në këto treva, Borka Josifovska bën përpjekjen për plotësimin e tekstit ekzistues (Dragojevic- Josifovska, 1971: 513-522) duke ia shtuar edhe fjalët në vijim: ëviva p(osuit) sibi/ /ët viro suoç, i cili i kompletuar do të dukej kështu:

PO SIS MESTYLU FI(LIUS) FL(AVIA) DELUS
MUCATI F(ILIA) DOM(O)
ALBANOP(OLI) IPSA DELUS

(dy rreshtat në vijim janë shtesë sipas supozimit të studiueses, Borka Josifovska)
/VIVA P(OSUIT) SIBI/ /ET VIRO SUO/



Mbishkrimi nga fshati Gorno Sonje të Shkupit (detaj)

6. Datimi i mbishkrimit

Mbështetur në teknikën e shkronjave të skalitura në mbishkrimin e kësaj stele studiuesit e kanë datuar në fund të shekullit I dhe të II, përkatësisht ndërmjet viteve 71-130, që do të thotë se ky datim përputhet deri diku edhe me përshkrimet e Ptolomeut që i sjell në lidhje me ekzistimin e qytetit antik ilir ALBANOPOLIS.

7. Mbiemri Albanos nga Stobi

Gjithashtu duhet përkujtuar se mbishkrimi nga Gorno Sonje duhet bashkëngjitur edhe mbishkrimin e zbuluar në qytetin antik Stobi, në afërsi të qytezës Gradsko (Veles). Në të dy herë është lexuar patronimi **Albanos** (Spasovska-Dimitriovska 1993-1995: 123-135). Epitafi në fjalë

ka këtë përmbajtje: “Në kujtim të djalit të tij Flavij Albanos, nga Emilijan Albanos”. Ky mbishkrim me të dhënat e tij paraqet jo vetëm një argument të fuqishëm për praninë e onomastikës ilire në territorin e Maqedonisë së sotshme, por përforcon akoma më shumë rëndësinë e burimeve të shkruara të autorëve antikë mbi fisin ilir ALBANOI. Në të njëjtën kohë këto mbishkrime sjellin dëshmi me të cilat hiqen të gjitha dilemat për atë nëse ka ekzistuar me të vërtetë ose jo vendbanimi me emrin ALBANOPOLIS. Sidoqoftë duket qartë se jo vetëm emërtimi ALBANOPOLIS, por edhe emrat e tjerë ilirë nuk përmenden rastësisht, por përkundrazi ata kanë pasur një shtrirje të gjerë në trevat ilire dhe kanë një rëndësi të veçantë për jetën e tyre shoqërore dhe administrative përgjatë periudhës romake.

7. Përfundim

Si përfundim do të shtonim se, me një interpretim më objektiv që mund t’u bëhet të dhënave të këtij dhe të mbishkrimeve të tjera ekzistuese, si dhe të disave të zbuluar kohëve të fundit jo vetëm nga rrethina e Shkupit, por edhe nga krahinat e tjera, paraqesin dëshmi me rëndësi të veçantë shkencore, të cilat flasin për shtrirjen e gjerë territoriale të onomastikës së pasur ilire nëpër trevat e ndryshme ballkanike.

Bibliografi

- DOBRUNA–SALIHU, Exhlale (2005), *Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës romake – sepulkrale dhe e kultit*, 1- 2, Prishtinë.
- DRAGOJEVIC–JOSIFOVSKA, Borka, (1971), *ADD. AD SPOMENIK, LXXI, 557 ALBANOPOLIS: Ziva Antika, XXII, 2 tom, Skoplje.*
- DRAGOJEVIC–JOSIFOVSKA, Borka (1982), *Inscriptions de la Mésie Supérieure, Scupi et la de région de Kumanovo: Centre D’études épigraphiques et numismatiques de la Faculté de Philosophie de L’université de Beograd, Vol. VI, Beograd.*
- GRUP AUTORËSH, (1979), *Illirët dhe Ilira tek autorët antikë, Ptolemeu, III, 20, Rilindja, Prishtinë.*
- HAHN, J. G. Von (1867), *Reise durch die Gebiete des Drin u Wardar.*
- ISLAMI, Selim (1975), *Monumentet I, Tiranë.*
- ISLAMI, Selim (1975), *Qyteti ilir në Zgërdhesh, Iliria II, Tiranë.*
- MIRDITA, Zef (1981), *Antroponimia e Dardanisë në kohën romake, Rilindja, Prishtinë.*
- VULIC, Nikola, (1931), *Spomenici: Spomenik, LXXI, 1931.*
- Спасовска-Димитриовска, Гордана (1993-1995), *Гробот на писарот од Стоби: Macedoniae Acta Archeologica 14, Македонско археолошко научно друштво, Скопје..*